

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar qytetarë, Ajo për të cilën unë bie dakord me zotin Ahmetaj është që duhet të debatojmë mbi fakte dhe, kur ka fakte, nuk ka pse të mos bie dakord për çfarë përmban fakti. Unë e kam kërkuar këtë që tha Kryeministri fillimisht dhe që sapo e përmendi përsëri zoti zëvendëskryeministër, që nga vjet sivjet janë shtuar 44 milionë euro subvencion për energjinë. Mbase nuk kam treguar kujdes, por, nëse janë, është një lajm i mirë. Nëse nuk janë 44 milionë euro, që janë shtuar nga sivjet për vitin tjetër, duhet shpjeguar çfarë, se mbase është shuma e subvencionit që është parashikuar për qytetarët që nga viti 1992 apo 1993. Megjithatë, të gjithë kemi arsye për të rënë dakord për faktet. Nëse ka një fakt, që unë mendoj se është evident për të gjithë dhe që i referohet pikërisht paketës fiskale të këtij viti dhe buxhetit, është që kjo paketë fiskale dhe ky dokument për herë të parë i ka bërë të gjitha bashkë shoqatat e biznesit, shoqatat e prodhuesve, bujqit, shoqatat e eksportuesve, të gjitha dhomat tregtisë dhe janë të gjithë të pakënaqur. Sa herë që kam dëgjuar buxhetet vitet e kaluara, kam parë një grup interesi të caktuar apo më tepër që kanë pasur gjëra të mira për të thënë. Diku ka pasur një premtim, diku një iniciativë, por këtë herë janë të gjithë të pakënaqur dhe ka një arsye pse. Për shembull, po e filloj me pjesën më vulnerabël, pensionistët. Këtë vit, për ata, pavarësisht çfarë thuhet, nuk do të ketë rritje të pensionit, por vetëm indeksim dhe në fund të vitit do t'u japin 5 mijë lekë shpërblim. Indeksi do të jetë jo për çmimet e produkteve të shportës, për të cilat ata shpenzojnë pjesën më të madhe në mos të gjithë pensionin, të cilat janë rritur me 10% apo 30%, por vetëm për inflacionin e INSTAT-it, 2%.

Meqë ra fjala, me këtë paketë fiskale qeveria është kujdesur që pjesën e indeksimit apo shpërblimit t'ia marrë shpejt e shpejt, sepse të gjithë pensionistët që përdorin gazin në shtëpi, për të gatuar dhe për t'u ngrohur, duhet të përgatiten që nga 1 janari do të paguajnë mbase 72 lekë apo 720 lekë më shumë për litër; kjo akcizë dhe TVSH mbi këtë akcizë. Në fakt, Kryeministri tha që nuk e kemi rritur dhe nuk do ta rrisim çmimin e energjisë, por e filloi me gazin, sepse gazi është pjesë e lëndëve energjetike dhe njerëzit e përdorin për të gatuar dhe ngrohur. E filloi me ata që do ta vuajnë më shumë, me pensionistët dhe me ata që kanë të ardhura të pakta, në një kohë që unë besoj se ne do të kishim një politikë, e cila do të incentivonte burimet alternative të energjisë që të mos përdoret energjia elektrike, meqenëse, siç thotë Kryeministri dhe siç është fakt, aktualisht çmimet ndërkombëtare të energjisë elektrike janë rritur, por ajo që bëmë ne ishte rritja e çmimit të gazit. Nuk po flas për cigaren, se do të më thonë që cigarja dëmton shëndetin, prandaj duhet ta rritim akcizën që të mos pinë njerëzit cigare, thjesht për të thënë që këtë vit konsumatorët e cigareve do të duhet të paguajnë rreth 9 milionë dollarë më shumë për paketat që do të konsumojnë. Të nderuar qytetarë, të varfër apo të pasur, pensionistë apo biznesmenë, jo vetëm që qeveria ka vendosur të marrë rreth 30 milionë akcizë më shumë nga ju këtë vit, por ka futur edhe një precedent shumë të keq, ka vendosur të rrisë taksat dhe tatimet pa pasur nevojë të mblidhet Kuvendi, në këtë mënyrë do të zerojë praktikisht çdo indeksim që u bën pensioneve dhe pagave. Ka vendosur të indeksojë edhe rritjen e akcizës.

Domethënë, nuk ka më nevojë të vijë në Kuvend, por, në qoftë se ka inflacion, me atë nivel, do të rritet automatikisht edhe akciza. Jo vetëm që është kjo një praktikë jotransparente e rritjes së taksave dhe tatimeve, jo më kot Kushtetuta ia ka deleguar këtë punë Kuvendit, por e shikoj si një mënyrë tinëzare të marrjes së lekëve nga xhepat e taksapaguesve. Vetëm për këtë ligji për akcizën nuk meriton të kalohet. Siç e thashë edhe më lart, sa herë ka kaluar paketa fiskale, kam dëgjuar edhe ndonjë fjalë të mirë, por si këtë radhë nuk kam parë që të bashkohen të gjithë dhe ta kundërshtojnë. E kundërshtojnë, sepse, së pari, nuk i ka pyetur askush kur i kanë hartuar ligjet dhe e kanë bërë fakt të kryer, të paktën kjo është ajo çka pretendojnë. E kundërshtojnë, gjithashtu, sepse me gjasa do të bëjnë një rritje çmimesh për qytetarët.

Sipas vlerësimit të tyre, pra të shoqatave, këto rritje çmimesh mund të shkojnë deri në 30%. Disa thonë se do i çojë në faliment. Ka shumë gjasa që përveç rritjes së çmimit, është e vërtetë shumë, do t'i çojë në faliment. Sa herë i kemi dëgjuar këtë periudhë, zonjat dhe zotërinjtë në qeveri t'i referohen pandemisë dhe tërmetit. Me këto dy fatkeqësi justifikojnë çdo gjë që nga borxhi dhe deri te vetingu, sa herë i kemi dëgjuar kur thonë që edhe shtetet e tjera kanë rritur borxhin, njësoj si ne, për pandeminë. Por duhet të themi që shtetet e tjera, në fakt, marrin para për t'ua dhënë qytetarëve dhe bizneseve për t'i mbështetur nga pandemia, të lehtësojnë barrën fiskale si të qytetarëve, edhe të bizneseve, por qeveria jonë nuk vepron kështu. Me sa duket, pandemia dhe tërmeti janë vetëm për hallet e qeverisë dhe jo të qytetarëve. Meqenëse jemi në vështirësi dhe meqenëse sapo kemi kaluar pandeminë, apo jemi ende në pandemi akoma dhe jo shumë larg nga tërmeti, qeveria ka vendosur të ndihmojë bujqit, duke u hequr rimbursimin prej 6% të TVSH-së për inputet bujqësore. Me këtë masë qeveria ka vendosur t'i ndihmojë, duke u marrë për vete në buxhet nja 8 milionë dollarë bujqve. Meqenëse ata janë keq, ka vendosur t'i ndihmojë edhe më shumë, duke u shtuar TVSH-në 10% për plehrat kimike dhe t'iu marrë 9 milionë dollarë të tjerë me këtë iniciativë që nga 1 janari. Në qoftë se thotë që do të shpërndajë subvencione, thjesht kujtoni që buxheti i bujqësisë për vitin 2022 do të jetë më i vogël në krahasim me vitin 2021. Pra, diçka është e sigurt në politikën bujqësore, qeveria merr këtë vit rreth 16-17 milionë dollarë më shumë taksa. E gjitha kjo, meqë jemi në krizë! Të njëjtën ndihmë ka menduar edhe për prodhuesit vendas të qumështit, të djathit e të tjerë. Meqenëse edhe ata janë në krizë dhe, meqë çmimet për disa produkte parashikohen të rriten në tregun botëror, qeveria ka vendosur të rrisë dhe barrën fiskale mbi to. Sipas prodhuesve, çmimet e produkteve të tyre do të rriten me 30%. Gjithashtu, dua të ngre këtu një shqetësim që, në fakt, e kam ngritur edhe në komision, sepse kam parë që është një skemë jashtëzakonisht shumë e rëndë dhe e keqe që po mundohet ta mbyllin me këtë ligj. Kjo paketë fiskale ka diçka tjetër interesante, zbuloi që deri tani qeveria ka shkelur ligjin, duke lejuar shitjen pa taksa të karburantit për jahtet dhe po bëhet gati ta legalizojë këtë skemë.

Për ta bërë më konkrete, qeveria ka lejuar që pronarët e skafeve ta blejnë karburantin në Shqipëri me 650 lekë të vjetër litrin, ndërsa çdo qytetarët shqiptarë, duke përfshirë edhe atë që punojnë tokën, e kanë blerë karburantin mesatarisht me 1750 lekë të vjetër litrin. Në kundërshtim me ligjin dhe me miratimin e qeverisë, jahtet nuk kanë paguar as akcizë, as TVSH, as taksë karboni, asgjë tjetër. Ky vendim i paligjshëm dhe klientelist u ka kushtuar shqiptarëve rreth 20 milionë dollarë në vit, sipas llogaritjeve që bën vetë Ministria e Financave, duke pasur parasysh që 18 mijë tonë i ka llogaritur që janë këtu. Nëse ligji do të zbatohet sot, duke qenë se ligji fiskal lejon të kthehet mbrapa 5 vjet për të marrë taksat, janë rreth 100 milionë dollarë që mund t'i marrim sot nga ata që janë furnizuar me këtë skemë të kundërligjshme. (Bie gongu.) Zonja Kryetare, kam përshtypjen që koha ime është 15 minuta, apo jo? Ajo çfarë ka vendosur të bëjë qeveria, është se do të vendosë një taksë, edhe këtë minimale, për karburantin e jahteve, duke legalizuar së pari, shkeljen e ligjit gjatë gjithë këtyre viteve, së dyti, nëse e bën këtë, do t'iu heqë mundësinë organeve tatimore dhe doganore të marrin rreth 100 milionë dollarë, për të cilat thashë që mund t'u merren sot. Në emër të Partisë Demokratike i kërkoj sot

Kryeministrit të tërhiqet nga ky vendim, sepse në këtë formë do të zhbënte çdo mundësi, çdo rast për të rikuperuar 100 milionë dollarët e munguar nga shitja e karburantit për jahtet. Po të dojë të mbledhë të ardhura dhe po të dojë të mos ua kalojë barrën bujqve, të mos ua kalojë barrën qytetarëve. Vetëm me këtë nismë ai mund të mbledhë pa asnjë problem 100 milionë dollarë për 5 vjet që kanë kaluar. Është mirë që qeveria të tërhiqet nga kjo taksë, jo vetëm sepse ligji aktual nuk i përjashton jahtet nga taksimi i karburantit, por sepse taksa e re sërish trajton me standard të dyfishtë jahtet dhe qytetarët. Qytetarët paguajnë sot rreth 1 000 lekë taksa në çdo litër karburant. Ndërsa ata që furnizojnë jahtet, do të paguajnë 650 lekë, gjithmonë të vjetër, taksa për litër, edhe me këtë taksë që po vendoset. Pabarazia është e qartë dhe është një propozim që duhet rrëzuar, sepse ligjet tona, si ai për akcizën, edhe ai për TVSH-në janë të përafuar me BE-në dhe mjafton të marrim referencë si i ka zbatuar dhe si i zbaton BE-ja këto dy iniciativa. Për ta mbyllur, dua të flas edhe për një ndihmë tjetër që po i jepet ekonomisë.

Në këtë kohë krize, kur të gjitha shtetet po mbështesin investimet, Shqipëria, që i numëron me gishta investimet e reja dhe investorët e rinj, po rrit kufirin për përjashtimin nga TVSH-ja të makinerive dhe pajisjeve me 10 herë, nga 50 milionë lekë në 500 milionë lekë. Një biznes i mesëm që do të investojë, do të duhet të paguajë 20% më shumë, si pasojë e kësaj iniciative, edhe kjo meqë jemi në krizë. Zonja dhe zotërinj deputetë, Paketa fiskale që shoqëron buxhetin këtë vit, së pari nuk është konsultuar me grupet e interesit. Së dyti, rrit pasigurinë si të ekonomisë familjare, ashtu edhe te bizneset. Së treti, shton kostot e pensionistëve, të bujqve, të bizneseve dhe do të ndikojë në rritjen në përgjithësi të çmimeve; Së katërti, godet prodhimin vendas dhe favorizon importet dhe, së pesti, nuk mbështet asnjë politikë të qëndrueshme ekonomike, përveç mundësisë për të rritur përkohësisht të ardhurat në buxhetin e shtetit Prandaj kjo paketë do të dëmtojë ekonominë shqiptare dhe për këtë ju ftoj të mos e votojmë. Faleminderit!2